



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 4, datë 27.03.2025

I mbledhjes së Këshillit të Bashkisë, për muajin mars, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”, mbledhja e radhës.(Ora 10:30)

Marrin pjesë:

- | | |
|---------------------|----------------------|
| 1.Rajmonda Zotaj | 21.Vjola Xhafaj |
| 2.Simo Petromilo | 22.Ledja Shollaj |
| 3.Edison Kapaj | 23.Bujar Osmënaj |
| 4.Vullnet Bilbilaj | 24.Geron Gunbardhi |
| 5.Frosina Qyrdeti | 25.Atird Hoxha |
| 6.Simbol Pazaj | 26.Ardian Musta |
| 7.Mujo Shakaj | 27.Shkëlqim Leskaj |
| 8.Myzafer Elezi | 28.Refie Laze |
| 9.Arsen Belaj | 29.Elpinqi Mërkuri |
| 10.Roland Strakosha | 30.Marsela Dashi |
| 11.Jerina Dervishaj | 31.Elca Bezhani |
| 12.Illir Aliaj | 32.Dikens Bushaj |
| 13.Gjergji Nika | 33.Grigor Dede |
| 14.Edlira Kapllanaj | 34.Aurora Qarri |
| 15.Liljana Breshani | 35.Anxhela Shenaj |
| 16.Ervis Moçka | 36.Besmir Brahimi |
| 17.Novrus Rrokaj | 37.Englantina Imeraj |
| 18.Brikena Sika | 38.Eglantina Aliaj |
| 19.Lorel Canaj | 39.Endri Hyseni |
| 20.Sokol Kushta | 40.Briseida Çakërri |
- Mungojnë :

- 1.Eneida Vera
- 2.Klodian Xhyheri
- 3.Ata Haluci
- 4.Brikena Puka
- 5.Anisa Ceno
- 6.Liri Dëma
- 7.Arjan Isufi
- 8.Erëmal Arapi
- 9.Evis Allushi
- 10.Eda Begaj
- 11.Gëzim Çapoj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal
Nr 4/1, datë 27.03.2025

Znj.Elpinqi Mërkuri – Mirëmëngjes!

Në emër të këshillit , uroj shumë suksese anëtarëve të këshillit që kandidojnë .

Vijojmë me shprehjen e ligjshmërisë.

Z.Gjergji Nika – Për procedurë. A mund të na vijnë drejtorët, zëvendëskryetarë ose Kryetari i bashkisë , pasi në mbledhjen e komisioneve nuk morra përgjigje nga drejtorët.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Lexon shprehjen e ligjshmërisë për VKB Nr 13 – 21, datë 25.02.2025 ku janë shprehur me akte me karakter individual dhe të ligjshëm nga Prefekti i Qarkut Vlorë.

Faleminderit.

Vijojmë me miratimin e procesverbalit të mbledhjes së këshillit, datë 25.02.2025 .

Votohet.

Pro – 36 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0

Miratohet.

Vijojmë me rendin e ditës.

Votohet.

Pro – 34 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 4/2, datë 27.03.2025

Znj.Elpinqi Mërkuri - Pika 1 e rendit të ditës, projektvendimi ”Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë për muajin Shkurt 2025”.
Kalojmë në votim?

Votohet.

Pro – 33 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota; 3 anëtarë pa votuar.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 4/3, datë 27.03.2025

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 2 e rendit të ditës, projektvendimi ”Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shkurt 2025”.

Votohet.

Pro -35 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 4/4, datë 27.03.2025

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 3 e rendit të ditës, projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 111, datë 27.12.2024 ”Për Buxhetin e Bashkisë për vitin 2025”.

Një referim nga drejtori përkatës.

Z.Kozma Mali – Në relacionin e projektvendimit ,për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 111, datë 27.12.2024, jemi bazuar në Ligjin Nr 9936/2008, i cili rregullon sistemin buxhetor, ligj i cili zbatohet nga pushteti vendor dhe ai qëndror. Kryetari i bashkisë me administratën ka hartuar projektvendimin , bazuar dhe në Ligjin Nr 139/2015 , Neni 8, pika 2 si dhe në Ligjin Nr 68/2017 , dhe Ligjin mbi Menaxhimin e Sistemit Buxhetor .

Fondet e trashëguara, fondet e miratuara do ti ngjiten fondit të Buxhetit të VKB Nr 111, datë 27.12.2024... Bashkia ka hartuar ...

Janë rakorduar me Degën e Thesarit, fonde të papërdorura;

-Granti pakushtëzuar – 380 mijë 072 ..

-Nga të ardhurat të papërdorura -1milion 107 mijë ..

-Granti specifik -158 mijë 548 ..., në Total 1milion 646 mijë ..

Bashkëlidhur tabela sipas shpërndarjes.

Në këtë projektvendim disa fonde të papërdorura, kemi vendosur ti fusim në disa prioritete për vitin 2025. Ishin fonde të papërdorura. Kemi sjellë dhe një ndryshim projekti kulturor, e kemi dsikutuar dhe në mbledhje komisioni.., si do vendoset nga këshilli.

Z.Gjergji Nika – A mund të na i thuash me zëra?

Z.Kozma Mali – Janë 3 ose 4 rrugë..Kur paraqitëm Buxhetin për vitin 2025, përveç investimeve , bazuar te të ardhurat , kemi vendosur dhe disa prioritete.

-Kemi rrugën e Kuzum Babasë;

-Rikonstruksion i rrugëve në fshatin Xhyherinë dhe fshatin Trevllazër .

Z.Gjergji Nika – Përveç 2 zërave shtesë , “Web Side” dhe “Giro D’Italia “ , pra përveç këtyre 2 projekteve , keni futur dhe 3 rrugë ?

Z.Atird Hoxha – Drejtori bëri arsyetimin e tij.

A i duhen bashkisë 65 milion lekë për “Web Side” e bashkisë ? Është shifër shumë e lartë .

Të miratojë këshilli për një “Web side” , 65 milion lekë dhe 36 milion lekë për “I Love Vlora “

Z.Kozma Mali – Ka qenë si investim dhe do të vazhdojë në vitet në vazhdimësi.

Z.Atird Hoxha – 35 milion, “I Love Vlora “, për këtë instalacion, ndërkohë që mungon pompa e Hidrovorit .

Ministria e Financave ka bërë publike një tabelë , për vitin 2024 , ku Bashkia e Vlorës, është e fundit.

Znj.Elca Bezhani – E kemi diskutuar.

Z.Atird Hoxha – 17,8%, Bashkia Vlorë, realizimi i investimeve. Planifikohen shumë, mbledhen pak. Jemi në fund , mbas bashkive të vogla. 17,8% performanca.

Na vjen një ristrukturim, por jo për investim....por për 65 milion “Web Side” dhe këtë instalacion 36 milion.

Z.Ervis Moçka – U kalua direkt tek diskutimet...Nuk duhet të hyjmë direkt.

Nëse, për të njëjtat projekte , sikurse dhe Webin...Këto projekte kanë preventiva, kanë çmime tregu.

Përsa i përket procedurës , meqenëse “I Love Vlora “, ka qenë parashikuar në buxhet , por në këtë moment, a mund të futen projektet e reja ? Duhet dhe mendimi i drejtorit juridik.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Këto janë diskutuar në komisione , le të na sqarojë dhe drejtori juridik, ku u paraqitën projektet “Web Side”, “Giro D’Italia” dhe “I Love Vlora “

Znj.Arlinda Tepelena - “I Love Vlora “ ishte i parashikuar në buxhet e vitit 2025.

Duke qenë se diskutimet zgjatën , ishte dhe ky projekt, kishte një lapsus, ishte vlera pa tvsh.

Instalacioni është i përhershëm , është metalik, duhet ti rezistojë kohës. Pra, të jetë instalacion i qëndrueshëm dhe të jetë i bërë në momentin që të fillojë “Giro D’Italia “ dhe me fillimin e sezonit turistik.

Është 4m e lartë dhe 12m e gjerë në pjesën e Lungomares. Janë llogaritur me preventiva. Nëse ka pyetje për instalacionin ?

Z.Gjergji Nika – Vlora 3 milion lekë, nuk duhet ti kalojë , të bëhet 3,6 milion dhe ëeb side , nuk ta lejon ligji i KQZ.

Të treja rrugët dhe rritja e asaj vlere, nuk duhet të ishin vënë.

Tërhiqini zërat, çfarë keni vënë tepër dhe, përmbajuni buxhetit.

Z.Atird Hoxha – Përsa i përket pjesës së alokimit të fondeve , deri në 11 Janar kemi kaluar lekët, fondin për familjet e përmbytura.

Për “Giro D’Italia”, “Web Side” dhe “Ilove Vlora”.., si do alokoni fonde se, deri në datën 11 Janar duhej, ti bënit llogaritë. Pra, disbursoni 60 milion lekë për “Giro D’Italia” , ku nga ministria ka një fond. Po nga bashkia, pse?

Përsa i përket shkeljes së ligjit, për alokimin e fondeve. S’kemi pse bëhemi palë.

Jeni në shkelje të ligjit për “Giro D’Italia”, 60 milion lekë. Kush është kuadri ligjor ?

Kemi kaluar shpërblimin për të përmbyturit .

Ne do votojmë kundër, ti vini në ndihmë “Giro D’Italia “ me 60 milion.

Z.Ervis Moçka – Zonja Kryetare! Kjo mbledhje po kthehet në debat me tre këshilltarë. Është institucion që e ndjekin dhe qytetarët. Kështu nuk vazhdohet. Ka ardhur materiali, ta dëgjojmë , ta relatojnë drejtorët. Ka kohë për shtjellim, për diskutim. Ka ardhur ky projektvendim, diskutimet në fund.

Z.Gjergji Nika – Ajo që diskutojmë, në radhë të parë të zbatojmë ligjin.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Drejtori juridik le të na sqarojë.

Z.Gjergji Nika – Ligji për KQZ-në, nuk e lejon të futet asnjë investim në këtë kohë . Ky projektvendim për zërat shtesë nuk duhet të vazhdojë. Prioritet nuk është buxheti.

Znj.Elca Bezhani – Buxheti shtesë, analizohet sot.

Z.Atird Hoxha – Kjo mbledhje..., dhe dëgjuam drejtorin që relatoi. Argumentet tona për të arritur në njëfarë mënyre që, përveç shifrave të fryra është dhe e jashtëligjshme.

Pra, u relatua nga drejtori i financës, vazhdojmë me diskutimet.

Z.Ervis Moçka – Jam i paqartë, ti dëgjojmë drejtorët.

Znj.Arlinda Tepelena – “Giro D’Italia” është një aktivitet dhe jemi shumë të nderuar që vendoset në qytetin tonë dhe, përkon me datën e zgjedhjeve. Numri i shikueshmërisë është i madh ...Ne me konsulencë nga Ministria e Sporteve dhe Kryeministri që ne të rrisim vizibilitetin ...6 milion lekë nuk janë vetëm për aktivitete artistike e kulturore , por dhe për infrastrukturën . Është mbështetje logjistike.

Z.Gjergji Nika – Ministria e Kulturës, ka dhënë 7 milion euro.

Znj. Arlinda Tepelena – Nga Ministria e Kulturës nuk ka ardhur asnjë fond.

Z.Ermal Dredha – Kjo është teknike, jo politike. Ideja është që ky eveniment, një herë ndodh . Është një event që ndiqet në të gjitha vendet e botës . Për “Giro D’Italia” kemi aplikuar dhe kemi fituar. Përsa i përket pjesës së 60milion është shumë pak , përfshihet këtu dhe logjistika..Kap lumin e Vlorës, Radhimë dhe më pas në Lungomare. Gjithë ky itinerar duhet të jetë ... 60 milion lekë/vjetra , s’janë asgjë në lidhje me fitbekun që fitojmë duke u bazuar në kërkesën e organizatorëve.

Ministria përkatëse ka akorduar një fond , por dhe ne si bashki. Do ketë shumë evente. E lejon apo jo KQZ, kontrata është bërë diku në muajin dhjetor...Nuk ishte kontrata gati. Nga ana njerëzore nuk ka asgjë. Ne nga 60 milion, s’mund ti harxhojmë të gjitha, mbase dhe 30 milion.

Z.Dorian Demiri – Përsa i përket kufizimeve, është një veprimtari që rregullohet me ligjin e KQZ, Vendimin Nr 9.

Po ta shohësh vendimin e KQZ, i bie që të gjitha vendimet e bashkisë të pezullohen.

Projektet në thelb nuk do shërbejnë për punën e partive apo personave, por për prezantimin e Shqipërisë. Nuk pezullohen aktivitetet artistiko – kulturore.

Znj.Elca Bezhani – Ky projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 111, datë 27.12.2024....” është një projektvendim që i erdhi koha të realizohen , janë disa fonde

të trashëguara nga viti 2024. Pra, sot ka ardhur momenti që ti transferojmë këto fonde nga ky buxhet i vitit 2024, për nevoja për vitin 2025. Viti buxhetor nuk përfundon në 11 Maj. Bashkia me fondet që ka, këto fonde të trashëguara, fondet shtesë, është momenti do të rishpërndahen. Ne në komision e diskutuam. Në fakt gëzuam, pasi në projekt janë 30 momente, segmente për rikonstruktion, të bëhen.

-Janë 2 zërat që diskutuam “Giro D’Italia” dhe “Web Side”, në lidhje me vendimin e KQZ.

“Giro D’Italia” nuk është projekt i tanishëm. Në relacion e ka sqaruar, për prezantimin e Bashkisë Vlorë. I kërkova dhe preventivat për këto dy projekte.

-Përsa i përket shpenzimeve ...Përsa i përket “Web Side” në komision, u kërkua nga drejtori juridik një relacion në lidhje me sqarimin për kohën parazgjedhore.

Viti buxhetor nuk është deri në 11 Maj.

Z.Grigor Dede – Në Komisionin e Ekonomisë kishim një projektvendim, për buxhetin shtesë.

Pra, fonde të papërdorura në vitin 2023 – 2024, do të rishpërndahen, këto janë miratuar në këshill për aktivitete dhe investime. Është diskutuar buxheti shtesë dhe këto dy pika “Giro D’Italia” dhe “Web Side”, që kërkova sqarim juridik...nuk dihej, që do zgjidhej data e zgjedhjeve, Vlora ofron qytetin, territorin e saj për zhvillimin e këti aktiviteti.

Pra, ju ftoj të gjithë këshilltarët ta shtojmë si pikë në buxhetin shtesë, për “Giro D’Italia”. Ne e votuam dhe ishim 4+1 kundër, të na sillte relacion nga ana ligjore në lidhje me procesin zgjedhor.. Pika 1, jam i sqaruar juridikisht. Për pikën 2, “Web Side” doja një sqarim dhe mendim. A jemi në kushte për ta kaluar në votim dhe pikën 2 “Web Side”?

Z.Atird Hoxha – Përderisa ka shumë debate, shihet që është në kundërshtim me ligjin e KQZ-së. Nga argumentat që tha dhe kryetari i bashkisë në lidhje me kontratën që u firmos më vonë. Është ndaluar me ligj përdorimi i fondeve nga 11 Janari. Jemi në situatën parazgjedhore që çdo alokim fondesh duhet të ishte deri në 11 Janar. Shumë mirë që vjen “Giro D’Italia”.

E duam, por është shkelje ligjore se, po përdoren fonde në momentin që s’lejohet. Që vendimet kolegjiale janë ta paatakueshme nga prokuroria...Nuk është vendim kolegjial. Ne kuptojmë anën njerëzore, por jo ligjoren.

Zoti Kryetar, thotë që, do hiqet “Web Side” si vlerë..

Po them për përdorimin e fondeve. Jam kundër “I Love Vlora”, të shkruhet dhe në gjuhën tonë “E dua Vlorën”.

Znj.Elpiniki Mërkuri – Ka shumë turistë të huaj dhe flitet në gjuhë internacionale.

Zoti Kryetar i bashkisë, propozon që ky projektvendim do kalojë pa vlerën e “Web Side” në votim.

Z.Ervis Moçka – Po dëgjoj që është e jashtëligjshme. Ku nuk lejohet Kodi Zgjedhor dhe një Vendim Nr 9 i KQZ, ka nenin 2, pika ku ka dhe veprimtari të ndaluara të cilat krijojnë benefite të caktuara, nxjerrin akte ligjore dhe nënligjore..prandaj, dhe ne u mbledhëm në janar për fondin e të përmbyturve. Më thonë, ku është e ndaluar për alokimin e fondeve për aktivitetet e “Giro D’Italia”?

A ka nen specifik, ku ndalohet ky eveniment, me këtë fond prej 6 milionësh..është shumë pak për këtë aktivitete.

Vlora është në qendër të 200 televizioneve botërorë.

Për një eveniment ndërkombëtar, bashkia mos të ketë një fond ?

Kush më thotë që, ka një nen, ma thoni, ma citoni. Ja kërkoj drejtorit juridik . Kë nen?

Projektvendim që japim bonuse...., nuk është as për partinë. Është vetëm për Shqipërinë, për Vlorën. Është në dobi dhe nderin tuaj për ta votuar.

Z.Gjergji Nika – Do ti tregoj ligjin , zotit Moçka.Përsa i përket aktiviteteve kulturore – artistike, nuk kam qenë kundër.

Kemi Vendimin Nr 9 të KQZ, pika 2/2...lexon.....veprimtari për tu promovuar , janë të gjitha veprimtaritë publike që dalin jashtë planifikimit të buxhetit. Vota ime është kundër.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim me propozimin e Kryetarit të bashkisë, për të hequr pikën e “Web Side”?

Votohet.

Pro 27 vota

Kundër 4 vota

Abstenim – 1 votë

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 4/5, datë 27.03.2025

Znj.Elpiniki Mërkuri – Pika 4 e rendit të ditës, projektvendimi “Për nisjen e procedurës për Transferimin e Aktiveve Afatgjata në Shërbimin e Ujrave të Bardha nga Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Vlorë, Sh.A në Bashkinë Vlorë”.
Nga drejtoria përkatëse ?

5 minuta pushim, ndërpritet mbledhja , ora 11:55.
Rifillon mbledhja në orën 12:06.

Znj.Elpiniki Mërkuri - Pika 4 e rendit të ditës. Lexon titullin e projektvendimit.

Z.Dorian Demiri – Është një procedurë, është një kërkesë e Ndërmarrjes së Ujësjiellësit që i ka dërguar Bashkisë Vlorë, që s’ka si objekt trajtimin e ujrave të bardha.Këto janë kanale të ujrave të larta dhe 4 stacione pompimi për transferim..Transferimi përveç pajisjeve përmbledh dhe fuqinë punëtore, godinën . Do ngrihet grupi i punës për vlerën e aktiveve, për inventarin dhe pas kësaj do të bëhet verifikimi. Thjesht nisim procedurën e verifikimit.

Z.Gjergji Nika – Projektvendimi nuk është i qartë, të tërhiqet. Procedura është, të ngrihet grupi i punës , të bëhet inventari.

Z.Dorian Demiri – Do gjejmë një ekspert të fushës, dhe duhet ta kalojmë për miratim, nisjen e procedurës.

Z.Gjergji Nika – Duhet të bëni inventarin, pastaj transferimin.

Z.Dorian Demiri – Shpërndarja e materialeve , nuk është detyrë e administratës, i paraqesim..

Z.Daut Zëraj – Jo, materiali ka ardhur , projektvendim dhe relacion.

Z.Gjergji Nika – Të tërhiqet projektvendimi, drejtori juridik ..

Z.Besmir Brahimi – Ka një pikë....transferimi i aseteve .., tek Bashkia Vlorë. Administrata duhet të na sjellë harta..Janë kanale të ujrave të zeza dhe derdhen të gjitha në det, nuk janë ujra të bardha. Duhet ti evidentojnë. Çfarë është bërë për pastrimin e kanaleve ?

Z.Dorian Demiri – Kanalet, është procedurë që nga viti 2015, kaluan nga Bashkia tek Ujësjiellësi. Do bëhet inventari. Ne do marrim vetëm kanalet e ujrave të bardha . Do bëjmë inventarin, a janë funksionale ? që mos të marrim gjëra jashtë funksionit.

Z.Ervis Moçka – Dua disa qartësime.Ekzekutivi kërkon leje ose autorizim që ata të na transferojnë ne. A ka ndonjë shkelje ?

Kush e pengon ekzekutivin që të ngrejë komisionin, të bëjë inventarin ?..të përcaktohet vlera .
Nuk mendoj se të pengon njeri , por dhe ta miratosh ?

Nuk kuptoj që ekzekutivi kërkon leje nga ne.

Bazuar në Ligjin Nr 139/2015, ekzekutivi është i detyruar të bëjë çdo gjë, çdo procedurë. Nuk mendoj që, ata të ngrenë këtë komision, të marrin miratim nga këshilli..., Ose të na thonë që janë bazuar në ndonjë ligj ..Ma thoni .

Z.Dorian Demiri – Kërkohet miratimi, pasi kërkojmë ekspert të fushës, bashkia nuk i ka. Pra, nuk prokurojmë dot shërbimin , pa miratuar nga këshilli. Do transferojmë aktive.

Z.Gjergji Nika – Pse bashkia po i merr, nuk i përballon dot. Ti s'ke vlerën për ekspertin.

Z.Shkëlqim Leskaj – Është problem që në vitin 2015. Kanë qenë në Bordin e Kullimit dhe në 2015 i kaluan Ujësllësit. Është bërë shumë mirë që do të bëhet ky kalim , nga Ujësllësi në Bashki.

Z.Novrus Rrokaj – Me këtë projektvendim, deri ku vete? Kush është hapi i dytë ?

Z.Dorian Demiri – Mbas vlerësimit , do krijohet një strukturë , por vetëm mbas inventarizimit , të qartësohet situata.

Z.Novrus Rrokaj – Mendoj që, administratën nuk e pengon asnjë, por bashkia, nuk do ketë mundësi.

Z.Ilir Aliaj – Kanë qenë pjesë e Bordit të Kullimit. Është nisur një procedurë . E përgëzoj bashkinë për nismën. Për çdo përmbyetje, i hidhet faji bashkisë. Duke u strukturuar kjo gjë, kanali që përshkon gjithë Çentralen, përfundon në det. Duke u konkretizuar gjëja , dihet kujt do ti kërkohet llogari. Unë mendoj që, kjo gjë duhet të kalojë në votim.

Z.Dorian Demiri – Nëqoftëse, nisim procedurën pa e sjellë në këshill....?

Nëqoftëse mbaroj procedurën..., ta solla inventarin.. Po të pyes ..Çfarë do ndodhë kur unë ta sjell? Kur kam mbaruar procedurën ..Ujësllësi, nuk i ka si objekt kanalet .

Z.Atird Hoxha – Përsa i përket këtij projektvendimi, ka shumë paqartësi. Deri tani nuk kanë qenë në administrim të bashkisë.

Bashkia Vlorë, i ka pas dhe tani do ti marrë bashkia për ti pastruar...

Bashkia Himarë nuk e ka votuar bashkimin e Ujësllësit, t'ia kalonin AKUM-it.

Përsa i përket projektvendimit , i kërkoj administratës, pse nuk nisni procedurat , të bëhet inventari..., le të bëhet dhe të vijë projektvendimi i plotë .

-E para, nuk është e vërtetë që bashkia , nuk i ka pas kanalet. Ka qenë Sh.A.Ujësllës Vlorë dhe sot vini me këtë pretendim.

Pra, a i keni pas apo s'i keni pas ?

Nëqoftëse, këto janë asete që do ti shtohen Bashkisë Vlorë , do ti kërkoja sekretarit , që ky projektvendim kërkon shumicë të cilësuar.

Z.Daut Zëraj – Ju e dini që, kur të vijë projektvendimi me inventarin, do shumë të cilësuar. Tani është thjesht nisje procedure.

Z.Atird Hoxha – Më vonë mund të thoni , e kemi kaluar si procedurë në parim.

Ju duhet të jeni shumë i kujdesshëm. Të nisin procedurat për transferim, zoti Sekretar .

Z.Daut Zëraj – Dhe nuk mund ta sillte administrata ?

Z.Atird Hoxha – Administrata në këtë rast do të lajë duart, jo të zbatojë ligjin.

Z.Daut Zëraj – Jo.

Z.Atird Hoxha – E kemi diskutuar në kohën kur e morri AKUM-i.

Nëqoftëse, kjo duhej ndarë që në fillim, Sh.A.Ujësjiellësi ka qenë pronë e Bashkisë, ndërsa sot AKUM-i merr ato që i intereson.

Z.Ervis Moçka – Kur e nisëm diskutimin , nuk ka problem dhe pse u votua. Ky është një nisje procedure. Nuk ka efekte financiare. Do ta sjellin për miratim, nuk ka lidhje.

Unë jam shumë i qartë për këtë projektvendim, por ju shoh juve pak të frkur, që për çdo gjë bëni, i sillni në këshill. Këto duhen marrë dhe t'ju krijojmë qytetarëve shërbim.

Doja sot, sa do ishte efekti financiar? Sa kanë marrë ? Sa janë vlerat, por jo të merrni miratim për të nisur këtë procedurë.

Meraku im është, për çdo gjë që është detyra, e drejta juaj, duhet ta bëni.

Z.Dorian Demiri – Këshilli është pronari. Do marrim një aktiv .

Z.Atird Hoxha – Gjatë relacionit ..nuk është objekt..., ajo që kemi bërë....pastrimin nuk e kanë objekt. Që në momentin e transferimit në AKUM, kush i administronte? Kush i kishte ?

Z. Dorian Demiri ---...

Z.Atird Hoxha – Qyteti ka pas disa probleme. Ujësjiellësi sot është përfshirë pjesë e AKUM-it, sot që j'ua kanë sjellë. Pra, nga dita që i keni miratuar transferimin AKUM-it, kush ka qenë autoriteti, pra përgjegjësi.

Z.Dorian Demiri – Sot kemi një kërkesë nga Ujësjiellësi , që ka këto aktive për t'i kaluar Bashkisë Vlorë.

Z.Atird Hoxha – Me të gjitha votat tuaja, ja keni dhënë AKUM-it.

Nëqoftëse AKUM-i,... që në fillim thatë që, këto nuk janë objekt i tyre. Pra, këto kanë qenë në mëshirë të fatit.

Z.Shkëlqim Leskaj – Ky inventar që ka kaluar në kontabilizim Ujësjiellësi..Në vitin 2015 nga Bashkia kanë kaluar në Ujësjiellës. Është bërë kërkesë nga Ujësjiellësi që ti kalojnë Bashkisë . I ka administruar Ujësjiellësi.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në votim.

Pro – 22 vota

Kundër – 6 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 4/6, datë 27.03.2025

Znj.Elpiniki Mërkuri – Pika 5 e rendit të ditës, projektvendimi “Për Miratimin e Marrëveshjes për Pagesën me Këste të Detyrimeve të Prapambetura , për Taksën e Ndriçimit, Pastrimit , Gjelbërimit si dhe Taksës së Pasurisë për Kategorinë Familje , të Agjentit “Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime “ Vlorë”.

Z.Gjergji Nika - Kam kërkuar në mbledhjen e komisionit , të jetë prezent Drejtori i Ujësjiellësit.

Z.Myzafer Elezi – Është një akt i paligjshëm, si në formë dhe përmbajtje . Janë të paligjshme, të paplota. Kjo marrëveshje nuk mbron interesat e Bashkisë dhe qytetarëve, por të Ujësjiellësit. Pika 6 ...lexon.. nuk diskutohet fare për kamat vonesat , pse favorizohet Ujësjiellësi dhe penalizohen qytetarët për pagesën e kamatvonesës. Kam disa riparime, disa propozime për projektvendimin dhe marrëveshjen.

Ka mungesë të ujit të pijshëm tek pallatet , tek ish-shtëpia e oficerëve.

Z.Gjergji Nika – Ajo marrëveshje, është e ligjshme apo jo ? Kamatvonesat nuk janë .

Z.Myzafer Elezi – Kjo është e paligjshme , sepse nuk përfshihen kamatvonesat., mbi principalin. -E kam parë me detaje këtë marrëveshje , për ta kaluar me ndryshime.

Z.Ervis Moçka – Thotë që është e paligjshme, pse ?

Z.Myzafer Elezi – Kjo draft-marrëveshje , është e paligjshme, nuk mbron interesat e qytetarëve.

Z.Ervis Moçka – Pse nuk është i ligjshëm ?

Z.Myzafer Elezi – Ku e gjeni që kamatvonesat qytetarët i paguajnë , ndërkohë favorizohet Ujësjiellësi . Kam propozime konkrete. Duhet të jenë prioritet interesat e qytetarëve.

-Titulli i paplotë.

-Neni 1 i marrëveshjes ..lexon....duhet të shtohen pagesat e prapambetura me kamatvonesat ..

-Lidhur me pikën 2..., pagesa të bëhet me këste mujore duke përfshirë dhe kamatvonesat.

Masa të jetë mbi 2 milion , pra 4 milion që të ulet afati .

Dhe tek projektvendimi dhe tek pika 1 e kësaj marrëveshje .

Dy janë mundësitë , ose të tërhiqet dhe të rregullohet ose,të votohet me propozimin tim.

Miratimi i detyrimit me me këste ...lexon... të përfshihet dhe pagesat e kamatvonesave mbi principalin.Propozoj të miratohet me ndryshime ose të tërhiqet.

Znj.Elca Bezhani – Lidhur me marrëveshjen , të gjithë jemi të ndjeshëm në lidhje me borxhin e Ujësjiellësit. Kompania nuk është e suksesshme , ky është borxh i keq.

Administrata është bazuar në Ligjin Nr 9920/2008, Neni 71,77 dhe 78 të këtij ligji për korrigjim Neni 68 të po këtij ligji, ka ngritur një grup pune në lidhje me pagesën e kamatvonesave mbi principalin.

Vendi, mënyra ...

Neni 77 shikohet dhe mënyra e pagesës. I kërkuam përfaqësuesve të Bordit dhe na thanë se agjenti tatimor nuk e ka marrë përsipër kamatvonesën, me Vendimin Nr 4 të Këshillit Mbikqyrës, nuk e merr përsipër të paguajë kamatvonesën. Pra, në këtë rast Bashkia do ti drejtohet Gjykatës, ndërsa për principalin po krijohet, po bëhet kjo marrëveshje. Vlera e kështit nuk do të ulet nga 2 milion. Ligji Nr 9920/2008 që rregullon marrjen e këtij borxhi. Kjo ndërmarrje nuk ka qenë e suksesshme.

Z.Atird Hoxha -Marr shkas nga diskutimi i zonjës Bezhani në lidhje me Bordin dhe që ata nuk pranojnë të paguajnë kamatvonesat. Ndërhyrja e zotit Elezi është me vend. Nëqoftëse, ne e miratojmë siç e kanë shkruar ata ...nëqoftëse, ata e kanë detyrim të paguajnë 2 milion euro, këto lekë i kanë marrë dhe sot na vjen kjo marrëveshje, jo vetëm që mos ti paguajë kamatvonesat por dhe që deri në vitin 2032.....

Unë mendoj që ky projektvendim duhet të tërhiqet, të negociohet, t'ia paraqesin këto shqetësime Këshillit të Bashkisë dhe të hyjmë në këtë marrëveshjeqë Bashkia të rikuperojë ...Mendoj që, duhet të tërhiqet si akt marrëveshje, të negociohet, të paguhen kamatvonesat dhe të shkurtohet ky afati deri në 2032. Negocimi kryesor të jetë pagesa e kamatvonesave dhe shkurtimi i afatit të shlyerjes.

Z.Geron Gunbardhi – Dua të theksoj, pasi zonja Bezhani, në mbledhjen e komisionit, ku unë votova, nuk është një borxh i keq, por është një vjedhje e pazbardhur, taksat e qytetarëve zhdukën. Përsa u përket kërkesave tona të përsëritura Bordit, duhen falënderuar, pasi kanë hedhur një hap për një marrëveshje.

Nuk mund të bësh një kontratë me 2 milion euro, 3-4 faqe. Ne nuk jemi kundër, thuhet gjërat ndryshe.

I falënderoj që kanë hedhur këtë hap, por të thonë ku i kanë çuar këto lekë, pastaj të tregojnë si i bëjnë në afate ...

Znj.Elca Bezhani – Zoti Gunbardhi, nuk e paska hallin tek problemi, por tek kryetare e komisionit. Në komision e dikutim. Drejtori nuk është. Ligji që theksova është për të zgjidhur këtë problem. Ka procedurë.

Kamatvonesat, ata nuk i paguajnë, do ti çojnë në Gjykatë. Grupi i punës po bën vlerësimin. Zoti Gunbardhimos të diskutojë, mos të krijojë probleme personale, nuk gënjej.

Z.Myzafer Elezi – Është e paligjshme, se bie ndesh me Ligjin Nr 48/2014, Neni 13 .., lexon.... citova dhe bazën ligjore, kërkoj ta tërhiqni projektvendimin. Vota ime është kundër,nuk mund të votoj në kundërshtim me ligjin. Marrëveshja në fjalë, është e paligjshme.

Z.Dorian Demiri – Në Nenin 6, ke penalitetet.

Z.Ervis Moçka – U përdorën lloj lloj termash. Të thuash që do paguajnëlihet pa shërbim një qytet i tërë. Borxhin nuk e fshehin, por ka pas paaftësi paguese. Po bëhen investime. E njohin detyrimin. Është tjetër faza e politikës dhe tjetër juridike. Asnjë s'mund ta falë atë që i takon.Dëgjuam zotin Elezi, por të dëgjojmë dhe drejtorin. Në lidhje me principalin, në lidhje me kamatvonesat, çfarë zgjidhje ka Bashkia. Cili nen jep zgjidhje. Nëse nuk rregullohet dhe puna e kamatvonesës, është e paligjshme... Të zgjidhet puna e kamatvonesës dhe principalit.

Z.Dorian Demiri – Në vitin 2021 Bashkia Vlorë , ka caktuar si agjent attimor Ujësjiellësin. Detyrimi fillon që prej 2021, 2022, 2023. Është ngritur grupi i punës dhe po vlerëson dhe rakordimet kanë nxjerrë një vlerë 191 milion lekë/reja , pa kamatvonesën . Rreth 72 milion kamatvonesën. Diskutoni që kemi falur 72 milion , Bashkia. Është njoftuar Drejtori i Ujësjiellësit për detyrimin që ka . S’kemi falur 72 milion. Kemi diskutuar për hyrje në një marrëveshje , ku njohim principalin , por jo kamatvonesat . Kemi diskutuar dhe folur për njohjen e detyrimit. Ujësjiellësi principalin e ka njoh, për kamatvonesën jo. Ne kemi propozuar një kësht 7-7,5 milion . Nuk kanë një performancë të mirë dhe bazuar në marrëveshje , vitin e parë të paguajnë 10 milion lekë. Në Komisionin e Ekonomisë e kemi diskutuar , që në marrëveshje , në Nenin 2, kemi shtuar një pikë, për pagesën e kamatvonesës, principalin e njeh, kamatvonesën , jo.

Z.Ervis Moçka – Kam një pyetje,... propozim, mund të bëhet apo jo ,... ne si këshill e njohim akt marrëveshjen..... “Për të njohur dhe kërkuar kamatvonesën..”

Z.Gjergji Nika – Pse nuk e tërheq ?

Z.Dorian Demiri – Muaj për muaj shikohet performanca.

Z.Atird Hoxha – E dëgjova zotin Demiri. Për fat të keq nuk kemi informacion në lidhje me këto takime , procesverbale dhe në përfundim, kush e ka përpiluar këtë marrëveshje ?

Z.Dorian Demiri – Kanë qenë pjesë e diskutimeve dhe me shkresa, 2 milion lekë.

Z.Atird Hoxha – Kush është argumenti që, nuk e njohin kamatvonesën e këtij principal.

Z.Dorian Demiri – Nuk e njohin, thjesht, nuk e njohin.

Z.Atird Hoxha – Nëqoftëse nuk e miratojmë , këta nuk i paguajnë ?

Z.Dorian Demiri – Do i paguajnë, e kanë pranuar, të formalizohet mardhënia.

Z.Atird Hoxha – Propozoj që ne të gjithë, Kryetare e këshillit, kryetarë të grupeve, të bëjmë një kallzim penal dhe të ëprpilojmë një akt padi .

Z.Ervis Moçka – Biem të gjithë dakort. Sipas zotit Hoxha do bllokuar...ka një rrugë më të thjeshtë . Ata nuk njohin kamatvonesën , jo principalin. Që mos të mbyllet kjo marrëveshje , jo vetëm me principalin. Të citohet Neni 2...Kjo marrëveshje është vetëm për principalin....vlëra...dhe nuk i heq të drejtën Bashkisë Vlorëdetyrimin , “kaq “ për kamatvonesën.

Z.Myzafer Elezi – Çdo marrëveshje, Neni 13 ...

Z.Dorian Demiri – Është Neni 6, penaliteti.

Z.Gjergji Nika – Propozoj në emër të anëtarëve të opozitës ;

-Principal, 191 milion detyrimi, të shënohet..

-72 milion kamatvonesat.

-Totali 263 milion ...Kësti për periudhën sa është ..dhe në muaj 26 milion /vjetra.

Z.Dorian Demiri – Po diskutohet është apo jo e ligjshme. Nëqoftëse ligji e parashikon penalitet, atë duhet ta përfshijë në Nenin 6 ...lexon... , nuk e kemi anashkaluar.

Z.Ervis Moçka – Ka një propozim të zotit Nika . Ujësjiellësi nuk e pranon kamatvonesën. E njohim dhe e duam borxhin...A mund ta rregullosh? A e riformulon projektvendimin duke përfshirë dhe kamatvonesën ?

Z.Dorian Demiri – Me këto pagesa, nuk i pranon Ujësjiellësi.

Z.Ervis Moçka – Sille, mos e përjashto kamatvonesën. Thuaje propozimin.

Z.Dorian Demiri – Referuar diskutimeve që po bëhen ..

Znj.Elpinqi Mërkuri – Nuk e njohim pa kamatvonesat .

Z.Dorian Demiri – Marrim përsipër që kur ta zbardhim , në Nenin 2 do të përfshijmë dhe kamatvonesën.

Përsa e sjellim , e mendoj të ligjshëm.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Ose do ta tërhiqni dhe ta rregulloni me propozimet e kryetarëve të grupeve , ose ta votojmë me propozimin që dha zoti Moçka , zoti Nika ? Drejtori thotë , në zbardhje do të bëhet.

Z.Ervis Moçka – Është pa kamatvonesën. Ka sjell një projektvendim , marrëveshjen e ka sjellë. Problem është kamatvonesa që u diskutua nga të gjithë.

Z.Dorian Demiri – Përderisa e sjellim në këshill, mendoj se është i ligjshëm .

Kërkon 5 minuta pushim për ta riformuluar.

Z.Shkëlqim Leskaj – Është ndërmarrje me humbje, s’ka pas mundësi të paguajë dhe jo më tej, kamatvonesën.

Unë mendoj të shtohet kësti, të bëhet 4 milion.

Them të negociohet që kësti të jetë më i lartë. Mos të paguhen kamatvonesat, por të rritet pagesa e vlerës mujore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal
Nr 4/7, datë 27.03.2025

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 6 të rendit të ditës, sa të konsultohet drejtori juridik, në projektvendimin “Për krijimin e Këshillit Artistiko Kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”, me një ndryshim të vogël. Zëvendësohet znj.Mirela Agalliu me z.Ardi Stefa.

Kalojmë në votim.

Z.Atird Hoxha – Kush i ka propozuar ?

Znj.Elpinqi Mërkuri – E kalojmë në votim ?

Votohet.

Pro – 24 vota

Kundër 1 votë

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2025

Procesverbal

Nr 4/8, datë 27.03.2025

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pika 7 e rendit të ditës, projektvendimi “Për Përcaktimin e Përfaqësuesve të Bashkisë Vlorë, në Bordet e Institucioneve Arsimore Publike dhe Jo Publike”.

Z.Ervis Moçka – S’kam gjë me emrat. Por në lidhje me Bordet , mos të quhet rutinë, por anëtarët e Bordit të shkollave dhe kopshteve , duhet të bëjnë punën , ka shumë probleme , ka shumë fenomene sociale. A mbledhen ndonjëherë këto borde ?

Znj.Elpinqi Mërkuri – Të nderuar këshilltarë. Projektvendimi 7 dhe projektvendimi 5, nuk kalojnë për miratim, pasi nuk ka kuorum.